


KËRKESA E SHOQËRISË CIVILE E LIPJANIT PËRFUNDON NË MINISTRINË E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

# “YAHR” i kërkon MAPL-së ta shfuqizojnë vendimin për laptopët e këshilltarëve

Arian Duriqi

LIPJAN, 26 MAJ - Pakënaqësitë lidhur me veprimin e këshilltarëve për të pronësuar laptopët e paguar me para të taksapaguesve në Lipjan janë riaktualizuar teksa të premtën shoqëria civile e kësaj komune me një letër të hapur drejt Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar shfuqizim të këtij vendimi. Në të vërtetë, ka qenë Asociacioni Rinor i të Drejtave të Njeriut (YAHR) që e ka kërkuar një gjë të tillë, pasi që prej momentit të vendimit për përvetësim laptoptësh nga këshilltarët e KK-së e ka konsideruar atë si të paligjshëm. YAHR i është drejtuar Departamentit ligjor në MAPL-së për rishqyrtim të shpejtë të kësaj çështjeje. “Vendimi i KK të Lipjanit në seancën 26-të 30 prillit 2012, lidhur me shndërrimin e asetëve komunale në këtë rast të laptopëve në pronësi private të këshilltarëve komunale është i kundërligjshëm. Ai së pari është në kundërshtim me Rregulloren komunale për funksionimin e punës së KK-së, sepse seanca është shpallur e mbyllur në orën 11:50, siç shkruhet edhe në ekstraktin e mbledhjes së 30 prillit 2012, pastaj është votuar për marrjen e një vendimi të tillë”, ka thënë Bekim Krasniqi në letrën, drejtuar MAPL-



Asociacioni Rinor i të Drejtave të Njeriut në Lipjan ka konsideruar se vendimi për përvetësim laptoptësh nga këshilltarët e KK-së e ka qenë i paligjshëm

së. Mirëpo, ky vendim po ashtu del se është në kundërshtim të plotë edhe me ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik neni 6, neni 7.1, neni 7.5, neni 7.7

dhe neni 7.8. Një veprim i tillë është i ndaluar për zyrtarët e lartë në bazë të dispozitës ligjore të këtij ligji në fjalë, në nenin 9. Aty thuhet: gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit të lartë i ndalohen këto

veprime, të ndikojë në vendimarrje të organeve legislative, gjyqësore apo ekzekutive duke shfrytëzuar pozitën e zyrtarit me qëllim të përfitimit personal, apo të personave të afërt apo të be-

sueshëm. Dhe meqë reagimet e shoqërisë civile në Lipjan lidhur me këtë punë nuk ishin marrë për bazë deri tashmi, YAHR ka vendosur që zbatimin e ligjit ta kërkojë me këtë rast në MAPL. “Kërkoj nga MAPL-ja të deklarojë se ky vendim nuk është i plotfuqishëm, se pari për shkak të shkeljes së Rregullores komunale për funksionimin e punës së KK-së e pastaj edhe që është në kundërshtim me ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik”, ka thënë Krasniqi. Në mbledhjen e KK të Lipjanit të 30 prillit 2012, këshilltarët asnjëherë nuk kanë qenë më unikë në votimin e tyre sesa në çastin kur votuan një propozim të tyre. Këshilltarët votuan duke shndërruar kështu asetet komunale, në këtë rast laptopët në pronësi të veten personale. Ndërsa ata i patën kushtuar Komunës 15 mijë euro. Ndërkohë kryesuesi i KK-së, Lulzim Rrustemi, ka ripërsëritur qëndrimin e tij se do të analizohet edhe një herë nga kompetentët e KK-së vendimi. “Kemi premtuar se gjithsesi do të ulemi për ta analizuar, por laptopët janë një material shpenzues dhe për këtë arsye kemi votuar dhe e dini se propozimi ka marrë mbështetjen e plotë”, ka thënë ai.